

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 E mërkurë, 13 tetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09:29 paradite

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita.

7 Znj. Sekretare, ju lutem, paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

9 kjo është lënda KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar  
10 kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Së pari, u kërkoj që të paraqiten palët dhe të  
14 pranishmit. Po mund të jemi dhe njësoj si dje.

15 Z. Prokuror, jeni njësoj si dje?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, është i njëjti ekip.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Mbrojtësja e Viktimave shikoj një ndryshim të vogël.

19 Z. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve. Të nderuar  
20 Gjykatës, sot përfaqësohemi nga Njomza Haxhibeqiri, Ndihmës  
21 Juriste dhe nga unë, Anne Pues, Mbrojtësja e Viktimave.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Nga ana e avokatit të Mbrojtjes.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka ndonjë ndryshim. I vetmi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 2

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ndryshim është që z. Mustafa është me videolidhje sot.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
3 mirë. Në rregull.

4 Z. Mustafa, lidhje a funksionon mirë? Më dëgjoni mirë?

5 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuara  
6 Gjykatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
8 mirë.

9 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet para Trupit  
10 Gjykues numër 1.

11 Ju lutem, shoqëroheni dëshmitarin që të hyj në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
14 dëshmitar, mirëdita. Mirë se erdhët në Dhomat e Specializuar  
15 atë Kosovës. Më dëgjoni?

16 DËSHMITARI: Po, mirë. Mirëdita.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
18 pushuat?

19 DËSHMITARI: Mirë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
21 mirë. Faleminderit, z. Dëshmitar.

22 Përpara se të vijojmë me dëshminë tuaj, dëshiroj që të  
23 diskutoj një çështje në seancë private.

24 Znj. Sekretare, ju lutem, të kalojmë në seancë private.

25 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 3

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
2 jemi në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Faleminderit, znj. Sekretare.

5 Vë re se dje mbrëma Trupi Gjykses ka marrë [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 Këtu mbyllet urdhri i lëshuar gojarisht.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 4

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Të rikthehemi në seancë publike. Znj. Sekretare, na  
2 kaloni në seancë publike, ju lutem.

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
5 jemi në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 Z. Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Ju  
9 rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën dhe  
10 për të mos mbajtur pa thënë asnjë dijeni që mund të keni  
11 lidhur me pyetjet që do t'ju bëhen.

12 DËSHMITARI: Ka mundësi një sqarim? Një kërkesë e kam?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
14 cila është kërkesa?

15 DËSHMITARI: Megjenëse unë kam studiu në lami tjetër,  
16 kërkoj nga Trupi Gjygues dhe Gjykatësja të më caktojnë një  
17 këshilltar juridik që t'i mbrojë të drejtat e mia ose të më  
18 këshillojë gjatë seancave sa jam këtu në Gjykatë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
20 ju kuptova mirë z. Dëshmitar, dëshironi që të keni një avokat,  
21 pra, një i cili t'ju japë këshillim juridik. Kështu e kuptova?  
22 Për dëshminë që do të jepni këtu në Gjykatë.

23 DËSHMITARI: Ashtu është, atë kërkoja.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta  
25 diskutojmë tani këtë. Së pari do t'ia jap fjalën Prokurorisë

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 së Specializuar, pastaj Mbrojtjes së Viktimave, pastaj  
2 Avokatit të Mbrojtjes. Po përpara se të zhvillohet ky  
3 diskutim, dua që t'ju pyes kërkoni këshillim ligjor apo  
4 juridik lidhur me çfarë gjëje?

5 DËSHMITARI: Jo vetëm të mbroj të drejtat e mia. Të mos  
6 më shkelen të drejtat e mia gjatë dhënies së deklaratës dhe të  
7 më këshilloj. Ma tepër këshilla.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu  
9 jeni për të thënë të vërtetën. Dhe doni këshilla ligjore  
10 lidhur me këtë?

11 DËSHMITARI: Kërkoj. Jo, për me thënë të vërtetën s'kam  
12 nevojë këshillave se jam betu. Vetëm kërkoj që të mos të më  
13 shkelet e drejta ime, të drejtat këto.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
15 t'ia jap fjalën Prokurorisë për të reaguar lidhur me këtë.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. E nderuar  
17 Gjykatëse, ne besojmë se të drejtat e dëshmitarit mbrohen  
18 plotësisht nga Trupi Gjygues, përgjegjësia e të cilit është të  
19 sigurojë ndër të tjera dhe respektimin e të drejtave të  
20 dëshmitarit. Siç e sugjeron edhe e nderuara Gjykatëse, duket  
21 se nuk ka ndonjë arsye përse dëshmitari mund të ketë nevojë  
22 për tu përfaqësuar me Mbrojtës. Sepse nuk -- ne, si Prokurori,  
23 nuk shikojmë se ka ndonjë çështje apo problem vetëfajësimi apo  
24 vetë inkriminimi. Nëse do të kishim më shumë qartësi lidhur me  
25 arsyen përse dëshmitari kërkon përfaqësim nga një mbrojtës

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 ligjor. Hë për hë nuk kemi ndonjë qëndrim lidhur me këtë  
2 çështje. Thjeshtë, deshëm që ta themi për procesverbalin që  
3 besojmë se të drejtat e dëshmitarit janë të garantuara  
4 mjaftueshëm kështu siç qëndrojnë gjërat deri tani.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit z. prokuror.

7 Mbrojtësja e Viktimave.

8 Z. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

9 Shumë shkurt. Dua të them se dëshmitarët mund të gjenden  
10 në situata të vështira, sidomos, kur nga njëra anë është  
11 dëshmia që lidhet qartazi me ngjarje shqetësuese mbase edhe  
12 traumatizuese, që është diçka të cilën e ka bërë të qartë  
13 dëshmitari gjatë seancës dje, si edhe vështirësia tjetër  
14 shtesë, kur dikujt i kërkohet që të dëshmojë pas 22 vjetësh të  
15 një ngjarjeje, pra, që ka kaluar një periudhë kaq e gjatë. Dhe  
16 kur dalin probleme p.sh., për të pajtuar apo përputhur dëshmi  
17 të ndryshme të veçanta, mbase të ishte e dobishme pasja e  
18 këshillave juridike për mënyrën sesi të zgjidhen p.sh.,  
19 problemet, le të themi, e kujtimeve që mbivendosen, format e  
20 ndryshme të së vërtetës. Se kujtesa është -- nuk është diçka e  
21 drejtpërdrejtë. Nuk është lineare, nuk është një video apo një  
22 fotografi e cila ka mbetur ashtu e regjistruar. Prandaj edhe  
23 detyra për të dhënë një dëshmi të vërtetë është ndonjëherë më  
24 e vështirë nga ç' duket fillimisht. Unë nuk jam tërësisht e  
25 sigurt se cila është praktika e brendshme kosovare, por me aq

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 sa di nga praktikat e brendshme të vendeve të tjera, e di që  
2 ndonjëherë dëshmitari ndodhet ndonjëherë në një situatë  
3 konfliktuese dhe praktika në këto raste është që, nëse e  
4 kërkon dëshmitari, ai merr mbrojtës për të mos patur asnjë  
5 rrezik të mospërbushjes plotësisht të detyrave të dëshmitarit  
6 kur ekziston ky rrezik. Lidhur me këtë, unë mendoj se vërtetë  
7 ekziston një arsye e vlefshme që dëshmitari ta paraqesë këtë  
8 kërkesë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit, znj. Mbrojtëse e Viktimave.

11 Z. Avokat i Mbrojtjes keni fjalën.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj se  
13 nëse pjesëmarrësi, në këtë rast bëhet fjalë për dëshmitarin,  
14 kërkon këshilla ligjore apo ndihmë juridike...

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni, nuk më vjen mirë që e  
16 ndërpres avokatin, po t'i kërkojmë dëshmitarit t'i heqë  
17 dëgjueset.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
19 Dëshmitar, mund t'i hiqni dëgjueset. Faleminderit.

20 Po thoshit se këshillat juridike...

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, nëse një pjesëmarrës gjatë  
22 këtij procesi si përpara apo gjatë procesit kërkon këshilla  
23 juridike apo ndihmë juridike të çfarëdo lloji, për çfarëdo  
24 lloji qofshin arsyet e tij, atëherë unë mendoj se kjo kërkesë  
25 gjithmonë qëndron, të paktën sa i takon Mbrojtjes.

1 Ne nuk kemi absolutisht asnjë kundërshtim për kërkesën që  
2 parashtrohet dëshmitari për të pasur mbrojtës apo këshilla  
3 juridike.

4 Unë do të doja të thosha, krahas kësaj, që nga ana  
5 praktike, gjëra të tilla edhe mund të zgjidhen shumë shpejt  
6 sepse e di që ekziston -- mund të ketë avokatë të gatshëm të  
7 cilët mund të përdoren. Unë nuk e di se cili është lloji i  
8 ndihmës juridike që dëshiron zotëria por, mbase, mund të jetë  
9 diçka e cila mund të zgjidhet nga mbrojtësi i tij.

10 Varet paksa nga kjo, nëse do të miratohej kërkesa e  
11 dëshmitarit duhet të shohim më nga afër faktin nëse këto janë  
12 gjëra që mund të zgjidhen shkurtimisht, në mënyrë që të  
13 rifillojmë mbase dhe sot apo mbase do të jetë e nevojshme për  
14 të rifilluar më vonë p.sh., nesër.

15 Nëse dëshmitari kërkon këshilla juridike, kjo është një  
16 kërkesë që gjithmonë qëndron. Është për arsye të vlefshme, për  
17 mendimin tim, kjo do të ndihmonte edhe vetë besimin e  
18 dëshmitarit apo për tu shprehur më mirë vetë për çfarëdo lloj  
19 çështje që mund të dëshirojë të diskutojë.

20 Pra, të nderuar Gjykatës, ne nuk kemi asnjë kundërshtim  
21 për kërkesën e dëshmitarit. Nga ana jonë mund të miratohet.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Shikoj se Prokurori është ngritur në këmbë. Unë gjithsesi një  
24 raund të dytë do ta jepja.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund të kërkoj që dëshmitari



*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 të largohet nga salla se dhe pse mund të mos ketë njohuri  
2 shumë të mirë të anglishtes, ai gjithsesi mund ta ndjekë  
3 diskutimin mendoj. Kështu që mbase mundet t'i japim leje  
4 dëshmitarit që dalë për një moment.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Mendoj se është një sugjerim i mirë. Nuk e di se ç'nivel të  
7 anglishtes ka dëshmitari.

8 Ju lutem, a mund t'i kërkonti dëshmitarit -- ta shoqëroni  
9 që të dalë nga salla.

10 Nuk e di nëse na ka kuptuar deri tani, mbase mund t'i  
11 vendos dëgjueset që t'ia them.

12 Z. Dëshmitar, po diskutojmë një çështje për të cilën  
13 mendojmë se është më mirë që të dilni nga salla dhe pastaj do  
14 t'ju kërkojmë që të vini prapë në sallë.

15 Faleminderit për mirëkuptimin.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
18 fliste z. Prokuror, pastaj do t'jua jap fjalën me të ardhur  
19 radha.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, mua më  
21 duket nëse flas mjaft sinqerisht është që, çështja këtu është  
22 se dëshmitari mendon se mund të ketë pasoja për një sërë  
23 mospërputhjes që kanë dalë nga dëshmia e tij dje, nga ajo që  
24 i ka thënë ZPS-së përpara dhe nga ajo që i tha Trupit Gjykses  
25 nën betim dhe vërtetë që ka pasoja ligjore për këtë. Por unë

1 mendoj që më mirë nga të gjithë është Trupi Gjykses ai që mund  
2 ta këshillojë dëshmitarin për këtë dhe në thelb e vetmja  
3 këshillë që mund t'i jepet është që dëshmitari të thotë të  
4 vërtetën. Nuk është se bëhet fjalë për ndonjë aspekt të  
5 ndërlikuar për të cilën ai ka nevojë për këshilla ligjore  
6 komplekse. Nuk ka nevojë që të ndërpritet procedura në mënyrë  
7 që dëshmitari të konsultohet me një avokat, i cili në thelb do  
8 t'i thotë që t'i tregojë të vërtetën Trupit Gjykses.

9 Unë nuk shikoj asnjë arsye pse dëshmitari duhet të  
10 asistohet nga një mbrojtës dhe do të ishte edhe çuarje dëm e  
11 kohës së Gjykatës.

12 A, nëse ka ndonjë arsye tjetër, shtesë, përse dëshmitari  
13 ka nevojë për mbrojtës, patjetër. Por, kjo arsye nuk ka dalë  
14 qartë deri tani.

15 Mendoj se është një çështje e -- nëse është vetëm puna, -  
16 më falni - për të thënë të vërtetën para Gjykatës nuk  
17 mendojmë, të paktën në këtë moment, që të ketë mbrojtës.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit, z. prokuror. Në fakt, pyetja ime do të ishte kjo  
20 që, a do të kishte mbajtur një qëndrim dhe cili do të ishte  
21 qëndrimi i Prokurorisë dhe ju na e bëtë të qartë qëndrimin e  
22 Prokurorisë tani.

23 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, ka ndonjë gjë që doni të  
24 shtoni tani.

25 Z. PUES: [Përkthim] Unë, thjesht, mund tu bëj jehonë

1 atyre që tha Avokati i Mbrojtjes. Mbase mund të jetë diçka e  
2 cila mund të bëhet lehtë dhe kjo do të ishte dhe pyetja e  
3 vlefshme që duhet bërë lidhur me një avokat në këtë rast.

4 Kështu që faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

6 Z. Von Bone.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse. Pikë së  
8 pari, sugjerimi i Prokurorisë se ky dëshmitar mund të bjerë  
9 ndesh lidhur, pra, mund të ketë konflikt, le të themi, midis  
10 dëshmisë së mëparshme dhe dëshmisë së tanishme, unë nuk shikoj  
11 ndonjë problem këtu, unë mendoj që sugjerimi që bën Prokuroria  
12 është i gabuar.

13 Kjo është pikënisja.

14 Pjesa e dytë e asaj që dua të theksoj është se në dritën  
15 e vendimit të mëparshëm sa i takon [REDAKTUAR]  
16 [REDAKTUAR] unë nuk jam i sigurt nëse ka ndonjë mbrojtës për  
17 dëshmitarin.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
19 falni, s'ju kuptova?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk di sesi ta shpreh në seancë  
21 publike. Më mirë mbase do të kalojmë në seancë private që të  
22 shprehem më mirë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
24 e kërkon patjetër.

25 Znj. Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 12

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, znj. sekretare.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit. Kështu është më

6 mirë disi.

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR] Po

19 atëherë, nëse do të thotë se ai nuk ka më mbrojtës, pra, ky

20 zotëri nuk ka më mbrojtës dhe, nëse ai kërkon një mbrojtës për

21 çfarëdo lloj arsye, qoftë kjo edhe për çështje të mëparshme

22 apo edhe për çështje -- ndonjë çështje tjetër e cila nuk është

23 mbuluar nga Prokuroria fare, atëherë, në bazë të kësaj mund të

24 ndodhë që mund të dëgjojmë se kjo është një temë e cila nuk

25 është cekur fare. Dhe mbase lidhur me këtë çështje dhe - më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 13

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 falni - dhe mbase lidhur me këtë çështje ka shumë mundësi që  
2 të bëhet kërkesa nga ky dëshmitar.

3 Unë kaq kam, po unë gjithmonë jam pro mbrojtjes nga  
4 avokatët, jo sepse jam vetë avokat po mendoj se është e  
5 rëndësishme që, për një proces ligjor si ky, çdo palë që merr  
6 pjesë në këtë gjykim, të mbrohet. Dhe këtu duket qartë që kemi  
7 të bëjmë me një kërkesë për mbrojtës të drejtash.

8 Ky është parashtrimi ynë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Janë  
10 bërë të qarta qëndrimet, se nuk jam shumë strikte. Nëse keni  
11 nevojë për një raund të tretë mund ta bëjmë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Shumë shkurt. Pikë së pari  
13 dëshmitari nuk është palë e procesit gjyqësor. Pra, të jemi  
14 shumë të qartë për këtë sugjerim që bëri avokati.

15 Së dyti, nuk ka asnjë arsye që të jetë bërë e qartë se  
16 përse, në mes të dëshmisë së tij dëshmitarit t'i jepet  
17 asistencë e mbrojtësit për diçka që unë mendoj mjafton që ta  
18 rikujtojë Trupi Gjyqësor për pasojat ligjore në bazë të ligjit  
19 kosovar, të ligjit për Dhomat e Specializuara sa i takon  
20 dhënies së dëshmisë së rreme. Me përjashtim të rastit kur  
21 dëshmitar mund të kishte arsye të tjera por nëse janë ato të  
22 parat, ne jemi kundër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
24 këtë e kisha të qartë. Unë thashë që nuk do isha shumë strikt  
25 për argumentet e reja.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 14

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni, e nderuar Gjykatëse.

2 Këto ishin të gjitha.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Ju keni argumente?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

8 nga kolegët...

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis

10 tyre]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo

12 që do të bëjmë është se do ta ndërpresim këtu seancën për

13 ndërkëshillim mes Trupit Gjykses. Nuk është e nevojshme që ta

14 sjellim në sallë dëshmitarin. Por, i lutem asistentes së

15 sallës, që t'i shpjegojë, ta informojë dëshmitarin lidhur me

16 këtë. Unë nuk e parashikoj dot sesa do të zgjasë ky

17 ndërkëshillim por do të kthehem sa më shpejt.

18 Në rregull atëherë të kalojmë në seancë publike.

19 Znj. Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë publike.

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës

22 jemi në seancë publike.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, znj. Sekretare.

25 Do të ndërpresim seancën këtu për të diskutuar çështjen

1 që kemi përpara.

2 Znj. asistente e sallës, ju lutem, informoheni  
3 dëshmitarin se do të zgjasë diçka më gjatë qëndrimi i tij  
4 jashtë sallës ndërkohë që ne ndërkëshillohemi si Trup Gjykses.

5 Këtu bëjmë ndërprerje të seancës.

6 --- Pauza fillon në orën 09:58 paradite

7 --- Seanca rifillon në orën 10.41 paradite

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
9 rifillojmë seancën. Znj. Sekretare të lutem, -- jo punonjësja  
10 tjetër të sjellë dëshmitarin. Ndërkohë vë re se palët janë me  
11 të njëjtën përbërje sa për procesverbal.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
14 Dëshmitar, mirë se ke ardhur përsëri.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
16 do të jap një urdhër me gojë. E mora parasysh kërkesën tënde  
17 z. Dëshmitar. Dëgjova dhe parashtrimet e palëve lidhur me  
18 kërkesën tënde për të kërkuar këshilla ligjore në këtë moment  
19 të procedurës.

20 Nuk ka bazë ligjore në kuadrin ligjor që ne të të ofrojmë  
21 një avokat në këtë moment, në këtë çast ku jemi në procedurë.  
22 Megjithatë je i lirë të kërkojë këshilla ligjore sipas  
23 dëshirës tënde jashtë kuadrit ligjor të kësaj Gjykate.

24 Tani do të rifillojmë dëshminë tënde me pyetjet që do të  
25 bëjë Prokuroria dhe dua të të kujtoj se duhet të thuash të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~)(Seancë e hapur)Riklasifikuar në bazë të F493 Faqe 16

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vërtetën, dhe se duhet t'i thuash Gjykatës gjithçka që di.  
2 Gjithashtu të kujtoj se në deklaratën që i ke dhënë më parë  
3 Prokurorisë, në Pjesën 7 ke thënë dhe për procesverbal numri  
4 është 061016-TR-ET, faqe 5 se gjithçka që ke thënë asokohe  
5 ishte e saktë, e vërtetë dhe besoj e konfirmon këtë?

6 DËSHMITARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
8 Prokuror ke përdorur dy orë e tetë minuta nga koha që të është  
9 caktuar. Tani ke fjalën për të vijuar me pyetjet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi  
11 në seancë publike, po jua kujtoj të gjithëve këtu.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ajo drita që keni vendosur aty  
13 është një kujtesë e mirë.

14 Të nderuar Gjykatës, dje i kërkuat Prokurorisë që të  
15 përditësonte vlerësimet për pyetjet kryesore që kemi. Nuk  
16 parashikojmë që të përdorim pesë orë që kishim, na ishte  
17 caktuar - është shumë. Do përpiqemi të përfundojmë sot në  
18 mëngjes.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

20 Faleminderit për këtë përditësim.

21 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani kam frikë se më duhet t'ju  
23 kërkoj të futemi në seancë private.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
25 kalojmë në seancë private.



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 17

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Vazhdoni z. Prokuror.

4 DËSHMITARI: W03594 [Vijon]

5 Pyetje nga Z. De Minicis: [Vazhdim]

6 Py. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

7 Pë. Mirëmëngjes.

8 Py. Dua të vazhdojmë aty ku e lamë dje përpara pushimit, dhe  
9 dje po diskutonim përpara se ta përfundonim bisedën që keni  
10 zhvilluar aty lart, te dhoma lart, tek ajo zyra siç e quajte,  
11 ku të çuan nga ahuri ku ishe mbajtur i ndaluar. Dje unë të  
12 pyeta nëse -

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe kjo gjendet në faqen 72,  
14 rreshti 2 deri në 12 të transkriptit të djeshëm.

15 Py. Unë të pyeta nëse pasi të kishin mbajtur aty disa ditë a i  
16 pyete njerëzit lart nëse mund të merrje në telefon familjen,  
17 dhe ti the, jo nuk e bëra këtë, sepse familja ime ishte jashtë  
18 dhe nuk e dije ku ti gjeje.

19 A të kujtohen këto fjalë që the dje z. Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: Po.

21 Py. A i pyete ata që të morën në pyetje? A u kërkove atyre që  
22 të kontaktoje familjen [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 Pë. Jo, nuk iu kërkova se ishte e pamundur një gjë e tillë të  
25 kërkoja.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 18

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj

2 që 061016-TR-ET, Pjesa 2, pra ky dokument faqja 11 të

3 paraqitet në ekran. Të kalojmë poshtë. Në rregull.

4 Faleminderit shumë.

5 Py. Prokurori të ka pyetur atëherë në lidhje me përfundimin e

6 bisedës lart në zyrë. Te rreshti 17, të pyet:

7 "Të kthyen në stallë apo ahur apo të çuan në vend

8 tjetër?"

9 Ti the:

10 "Jo, më kthyen aty ku isha."

11 Ai tha:

12 Py. "Në rregull. I kërkove atyre të kontaktoje familjen."

13 Ti përgjigjesh:

14 "Po, sigurisht."

15 Dhe ai të pyeti:

16 Py. "A të lejuan?"

17 Ti the:

18 Pë. "Jo, jo, nuk më lejuan edhe pse [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR] U

20 përpoqën të më kontaktonin por nuk i lejuan."

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kaq kisha nevojë për momentin.

22 Py. Pra z. Dëshmitar dukesh sikur prapë ndodhesh në një

23 situatë ku ka mospërputhje të mëdha midis asaj që i ke thënë

24 Prokurorit atëherë - me një farë sigurie ia ke thënë. "Po,

25 sigurisht". Tani këto që të lexova a të kujtohet, a të bëjnë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 19

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të kujtosh ato që ke thënë kur i ke pyetur ata ose nëse i ke

2 pyetur [REDAKTUAR] apo [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR] me familjen [REDAKTUAR]

4 Pë. Z. Prokuror, unë jam shërbyes i qartë në jetë. E di çka

5 kam thonë. Mund të jem keqkuptu se nuk i kom pyt ata

6 [REDAKTUAR] Unë e thashë edhe dje

7 më 2 prill [REDAKTUAR] e kom marrë vesh [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 Dhe e dyta ka qenë e pamundur aty të kontaktosh me dikë

12 tjetër ose të kërkosh familjen. Edhe po të ishte [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR] ata s'do ta lejonin të vinin në burg. S'kanë leju

14 asnjë vizitë, jo ndaj meje, jo vetëm për mua, po s'kanë leju

15 për kurrkënd kurrfarë vizite.

16 Unë mund të jem keqkuptu. Mund të kem thonë nuk e them,

17 po me vetëdije të plotë e them se nuk kom kërkua prej tyre as

18 nuk kom ditë se [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR] Pas daljes më kanë tregu se kanë qenë X herë edhe

20 u kanë bo atyne presion pse e keni marrë mikun tonë nga

21 shtëpia jonë. Kjo është e vërteta. S'kam pasë kurrfarë mendimi

22 unë [REDAKTUAR] Edhe po të

23 kërkoja ata s'kishin as telefona për vete e le mo - edhe po të

24 ma jepnin telefonin [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 20

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR] Ndoshta e kom thonë, nuk du me hy, e kom  
2 thonë jom keqkuptu se nuk kom kërku kurrfarë ndihme prej tyne  
3 as nuk kom pasë njohuri pse kanë ardhë ata me më bo presion me  
4 më liru se unë brenda për brenda kom qenë. Vetëm e di se asnjë  
5 vizitë nuk është leju, jo ndaj meje por kurrkush nuk është  
6 leju me ardhë me vizitu, ndonjë anëtar i familjes, ndonjë i  
7 burgosur aty brenda.

8 Py. Më vjen keq, një minutë. Pyetja nuk ishte nëse lejoheshin  
9 vizitat. Për këtë ishe i qartë, i ke thënë nuk ka ndodhë, nuk  
10 mund... Po këta njerëzit, [REDAKTUAR] që të trajtuan nuk ta  
11 plotësuan kërkesën. Pyetja ime ishte kjo. A kërrove ti vetë që  
12 ti shihje të kontaktoje, pra [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 Z. Dëshmitar, një minutë. Ti je një person që di të  
15 flasësh dhe je i qartë, dhe nuk besoj që ishte e lehtë që të  
16 keqkuptohesh. Pra ti e ke dhënë përgjigjen me një farë  
17 sigurie. Pra përgjigjja jote sot është që ti nuk kërrove

18 [REDAKTUAR] Këtë po thua sot

19 përpara Trupit Gjykes? Je nën betim.

20 Pë. Unë po e them edhe nën betim, po e thom me përgjegjësinë  
21 më të madhe morale që s'kom kërku prej tyne se s'më ka ra  
22 ndërmend në ato momente të kërkoj, të kontaktoj dikënd tjetër.

23 Unë e thashë edhe dje. Ka qenë bisedë vëllazërore. Unë kam  
24 mendu që atë ditë më lirojnë. Kjo ka qenë përshtypja ime. Nuk  
25 kam kërku. Ndoshta para atje e kam thonë, nuk e mohoj që se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 21

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kam thonë, por e kom thonë në një efekt tjetër, pa vetëdije  
2 ose nuk e di, nuk muj me marrë me mend se unë e kom deklaru  
3 diçka që jam i bindur që s'kom kërku. Po të kisha kërku unë se  
4 mbroj askënd. Edhe sot thom kisha kërku ndaj tyne. Nuk ka qenë  
5 ndonjë rast ose ndonjë moment ku mundesh ti me kërku diçka me  
6 të vizitu dikush në burg, [REDAKTUAR]  
7 [REDAKTUAR], për ata që kam qenë i strehum. S'kam pasë ide  
8 me kërku të më vizitojnë ata. Kjo është e vërteta z. Gjykatës  
9 [sipas përkthimit].

10 DËSHMITARI: Unë...se s'është kurrfarë qëllimi...

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Përgjigjja juaj është e qartë.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 Py. Faleminderit. Faleminderit për përgjigjen. Mjafton.

15 Z. Dëshmitar, dua të të bëj nja dy pyetje që Trupi  
16 Gjykses ta kuptojë më mirë se cilët ishin njerëzit me të cilët  
17 ti mbaheshe i burgosur.

18 Dje nëpërmjet dëshmisë tënde përmende tre emra, tre  
19 persona. Jemi në seancë private. Njëri ishte [REDAKTUAR].

20 Tjetri [REDAKTUAR] dhe një tjetër ishte një burrë nga  
21 [REDAKTUAR], n.q.s. e shqiptova mirë. A të kujtohet që këta  
22 janë tre personat që i përmende dje?

23 Pë. Është e vërtetë. Po edhe një kur ka ardhë ma vonë është  
24 qujt [REDAKTUAR]. Ashtu e kanë thirrë ata. Ka qenë i ri.

25 D.m.th. tre edhe katër. Dhe atë të katërtin se kam njoftë e as

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 22

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 nuk e kom ditë i kahit është por e kanë qujt [REDAKTUAR]
- 2 Është e vërtetë që këta kanë qenë me mu.
- 3 Py. Faleminderit. Sepse e përmende edhe [REDAKTUAR] e vërtetë
- 4 është. Ky personi nga [REDAKTUAR] a të kujtohet ndoshta
- 5 rastësisht si e quanin, emri i tij?
- 6 Pë. Nuk e di, se po ta dija do ta thoja. Ka qenë një djalë i
- 7 gjatë gati sa unë me trup, po emnin nuk ia di.
- 8 Py. A të kujtohet - a mësove arsyen pse ai mbahej i burgosur
- 9 aty? A more, e mësove këtë gjë gjatë kohës që qëndrove apo më
- 10 pas?
- 11 Pë. Z. Prokuror asnjë aty sa ishim brenda nuk jepte asnjë
- 12 sqarim pse është aty. Ju thom me bindjen ma të plotë. Asnjë
- 13 nuk ish në gjendje me përshkru pse ishin të gjithë sipas tyne
- 14 ishin të pafajshëm. As që kam hy me i pyt unë pse janë aty. As
- 15 ata mu s'më kanë pyt. D.m.th. të gjithë ne brenda e kishim të
- 16 njëjtën brengë, çfarë kushtesh, çfarë rrethanash, edhe
- 17 mendonim a na nxa mëngjesi a jo. Kjo ishte ajo. Nuk kishim
- 18 njerëz që komunikim shumë ka je, qysh je, qysh e ke emrin,
- 19 mbiemrin, ishin në një gjendje shumë jonormale. Nuk kemi
- 20 bisedu. Vetëm e di edhe ata kur kemi dalë më ka thonë se është
- 21 nga [REDAKTUAR]. Kur kemi dalë, kur na kanë liru rrugës e kam
- 22 marrë vesh që ai është nga [REDAKTUAR].
- 23 Py. Faleminderit.
- 24 Pë. Edhe për [REDAKTUAR], duhet ta - edhe për [REDAKTUAR] e
- 25 kom marrë vesh pasi kom dalë, rrugës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 23

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Dëshmitar? Një nga një Prokurori do të tregojë se çfarë

3 dëshiron të të pyes, se ai ka atë listën me pyetje po

4 faleminderit për atë që the.

5 Z. Prokuror, vazhdoni.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

7 Py. Z. Dëshmitar, të pyes sepse dje na the që kur njerëzit

8 silleshin, kur njerëzit hynin në ahër - rojet - thoshin ndonjë

9 fjalë se, "Pse mbaheshin aty". Nuk e kam referencën po më

10 duket sikur të pyetën "pse rri me këta njerëz? Ky është  
[REDAKTUAR]

11 ky është [REDAKTUAR]", a të kujtohet që i ke thënë këto fjalë?

12 Pë. Jo, për [REDAKTUAR] nuk më kanë thonë. Po më kanë thonë

13 se ky është [REDAKTUAR]. Për [REDAKTUAR] kam dëgju kanë

14 përmendur po mu s'mu kanë drejtu, po kom dëgju ka i drejtohen

15 si [REDAKTUAR]. Ky është [REDAKTUAR]. Mu mu kanë drejtu

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Py. Është e qartë. E kam të qartë.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem

20 të paraqitet në ekran dokumenti me numër 061016-TR-ET, Pjesa

21 3, rreshti 16 [sipas përkthimit], ju lutem. Faqja 13.

22 Py. Z. Dëshmitar, po të pyes se këto që do të lexoj mbase do

23 ta freskojnë kujtesën, se kur Prokurori të ka pyetur për

24 personin nga [REDAKTUAR] ke thënë -

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po lexoj nga rreshti 12 deri ke

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 24

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 16.

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 "Py. Si e quanin?"

7 "Pë. E kam harruar. [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 Pra, z. Dëshmitar, nga kjo pjesë që sapo ta lexova duket  
11 sikur ke mësuar disa gjëra sipas atij, pra prej atij, nga ai  
12 njeriu nga [REDAKTUAR] lidhur me arsyen sepse mbahej aty i  
13 ndaluar.

14 A ta freskon kjo kujtesën për këtë çështje, për këtë  
15 pyetje që po të bëj?

16 Pë. Është e vërtetë, po unë nuk muj me të marrë si të saktë  
17 çka më ka thonë ai rrugës ose aty. D.m.th. nuk i kam marrë të  
18 sakta asnjë...

19 Py. Një minutë, një minutë zotëri. Nuk është puna jote të  
20 vlerësosh fjalët apo dëshmitë e të tjerëve. Ti ke thënë gjoja,  
21 pra nuk ka nevojë që të përpiqesh që çdo herë ta bësh këtë  
22 sepse thuhet në deklaratë.

23 Pë. Është e vërtetë që e kam thonë.

24 Py. Tani the që ishin dhe dy të tjerë, të rinj. [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR] Ke thënë, ai [REDAKTUAR]



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe kjo gjendet në Pjesën I të  
3 intervistës, në faqen 23, gjithmonë me numrin që kishim, pra  
4 061016. Nuk kam nevojë ta shikojmë në ekran, po sapo për  
5 procesverbal. Faqja 23.

6 Të nderuar Gjykatës, nuk e di nëse keni ndërmend të bëni  
7 një pushim?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pres  
9 të dëgjoj nga Njësia e Përkthimit dhe nga Njësia e Menaxhimit  
10 të Gjykatës për të parë se si do të vazhdojmë sepse u desh një  
11 farë kohe që të bënim ato diskutimet tona. Pra do t'ju njoftoj  
12 sapo të dëgjojmë prej tyre. Pra mund të vazhdoni. Mund të  
13 vazhdoni me pyetjet.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 Py. Ky [REDAKTUAR] që na the mbërriti më vonë-a të kujtohet nëse  
16 ka qenë më i riu apo më i madhi nga aty, nga njerëzit që  
17 ishin, që mbaheshin aty të ndaluar?

18 Pë. Ka qenë më i riu. Ka qenë shumë i ri.

19 Py. Faleminderit. Ai [REDAKTUAR], që ti the në atë  
20 kohë ishte rreth 17-18-19 vjeç. A mësove kur ishe aty se pse e  
21 kishin ndaluar atë aty? Dhe përsëri mos të bëjmë vlerësimin  
22 nëse ato që mësove ishin apo jo të vërteta. Pyetja ime është,  
23 a e mësove ti sepse ishte ai i ndaluar aty?

24 Pë. Jo, nuk mësova. Edhe unë duhet të deklarohej këtu, kur  
25 them 17-18 vjet e kam fjalën [REDAKTUAR]. Ndoshta jam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 26

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 keqkuptu. [REDAKTUAR]. Përshtypja ime ishte 17-18 vjeç, bile  
2 ndoshta si ka pasë as 18 vjet. Por këtë të [REDAKTUAR] nuk e  
3 di. Të [REDAKTUAR] ka qenë vetëm [REDAKTUAR] me sa di unë. Për  
4 këtë personin tjetër ndoshta e kom thonë, nuk di a ka qenë i  
5 [REDAKTUAR], nuk e di. Edhe ai nuk ka qenë shumë i ri.

6 Në dhomë ka qenë ma i riu ky [REDAKTUAR]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
8 ishte kjo pyetje që tu bë z. Dëshmitar.

9 Z. Prokuror, keni fjalën.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 Py. Pra nuk të kujtohet nëse e ke mësuar, nëse ky personi,  
12 përse mbahej i ndaluar personi nga [REDAKTUAR]? Këtë do të  
13 thuash?

13 Pë. Nuk e di. Nuk e di. Për të nuk e di.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbase të nderuar Gjykatës,  
15 është mirë të shohim dokumentin 061016-TR-ET, Pjesa 3, faqja  
16 12 në ekran. Dhe do të lexoj rreshtin 4 deri në 12.

17 Py. Z. Dëshmitar, gjatë intervistës Prokurori të ka pyetur  
18 për atë personin [REDAKTUAR].

19 Dhe ti ke thënë:

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 Prokurori të ka pyetur:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 27

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 "Në rregull. Për çfarë keni bisedu me të?"

2 Edhe ti je përgjigj:

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 Pra ke dhënë, duket se ke dhënë mjaft informacion

9 Prokurorit, informacion të hollësishëm do të thoja unë, lidhur  
10 me atë personin nga [REDAKTUAR] - dhe pse siç mësove ti e  
11 kishin sjellë aty, e kishin ndaluar. A të kujtohet tani këto  
12 që i ke thënë Prokurorit atëherë pasi t'i lexova?

13 Pë. Ndoshta, edhe njëherë po ju thom, nuk më kujtohet, edhe  
14 sot nuk më kujtohet ai person. Ndoshta e kam thonë po e kom  
15 thonë në një efekt tjetër, nuk e di. Përpos, edhe njëherë  
16 [REDAKTUAR] për këta as

17 [REDAKTUAR] as për këtë nuk kam pasë farë informacioni.

18 Ndoshta rrugës kur kemi dalë, as sot nuk e di, ka thonë  
19 tjetërkush ka thonë që ky [REDAKTUAR]. Ai vetë personalisht  
20 s'më ka thonë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

22 Prokuror, dua që të flas me Dëshmitarin.

23 Z. Dëshmitar, ajo që është e shkruar këtu në dëshmi, në  
24 deklaratën tjetër, është përkthimi i fjalëve që ti i ke thënë  
25 Prokurorit në 2019-n. Pra mund t'i japësh sqarim lidhur me ato

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 28

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 që ke thënë. Mund të thuash, s'më kujtohet që ta kem thënë,  
2 por ideja është që nuk është sajuar nga mendja e njerëzve që  
3 kanë qenë aty me ty. Ata kanë shkruar ato që ke thënë ti. Pra  
4 i ke thënë këto fjalë në atë kohë?

5 DËSHMITARI: Gjykatëse, edhe njëherë po e përsëris.

6 Këto fjalë mrena burgut nuk i kam dëgju. E thashë edhe  
7 njëherë po e sqaroj, nuk kemi bisedu. Kur kemi [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR] Është e vërtetë që - po unë me fjalët e rrugës

16 edhe njëherë. Ndoshta jam keqkuptu me Prokurorin, por edhe

17 njëherë brenda për brenda burgut, nuk kemi pasë asnjë lloj

18 informacion përpos [REDAKTUAR] që e kam dëgju, që më kanë

19 thonë ky është [REDAKTUAR]. Edhe [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është

22 e qartë. Është e qartë.

23 Faleminderit z. Dëshmitar.

24 Keni fjalën z. Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 29

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Z. Dëshmitar, kalojmë tani tek fundi i bisedës që ke pasur  
2 me njerëzit aty lart, te ahri lart. Çfarë ndodhi kur  
3 përfunduan pyetjet?

4 Pë. Për kur e keni fjalën z. Prokuror?

5 Py. Të kërkoj ndjesë. Pra të çuan lart tek zyra, tek ajo zyra,  
6 zhvillove atë bisedën me ata njerëzit dhe në një moment mbaroi  
7 biseda, çfarë ndodhi pasi mbaroi biseda jote me ta?

8 Pë. Pasi mbaroi biseda me ta u përshëndetëm dhe unë kisha  
9 përshtypjen edhe njëherë, edhe dje e kam thonë, se unë do të  
10 lirohem, nga sjellja e tyre njerëzore që unë e kisha

11 përshtypjen. Unë nuk kisha ide se do të shkoj në ahër prapë.

12 Erdhi ai i njëjti person që më çoi lart, priste te dera dhe më  
13 mori më çoi në ahër. Kjo ishte e vërteta. Dhe ishte një  
14 dëshpërim total i imi.

15 Py. Pasi të kthyen në ahër na the se vazhdove ndenje aty deri  
16 sa të lirun, kështu?

17 Pë. E vërtetë.

18 Py. Dua që të mendosh për datën kur të kanë liru, mbase ishte  
19 18, dita e 18-të apo diçka e tillë. Mbase s'të kujtohet data e  
20 saktë.

21 Py. Sot nuk më kujtohet se s'kam arsye me thonë 18 ose 19. Nuk  
22 më kujtohet. S'kam qenë në gjendje të mendoj aq shumë kur kam  
23 dalë. Kam qenë gati njeri i humbur nuk e di. S'kemi pasë as  
24 orë, as datë, as, s'kemi mbajtur mend asgjë. Se për mu nuk është  
25 në interes të them 18, d.m.th. ka qenë data ose 18 ose 19,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03594 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga Z. De Minicis (Vazhdim)

Faqe 30

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 këto dy data kanë qenë që na kanë liru.

2 Py. Faleminderit. A të kujtohet sesa qe ora kur të liruan?

